

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 4-2021

RRITJA DHE ZHVILLIMI I FËMIJËVE TË MOSHËS PARASHKOLLORE NË KOMUNËN E FERIZAJT

Kastriot Ilazi

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Medical Sciences Commons](#), and the [Nursing Commons](#)



Kolegji UBT

Fakulteti i Infermierisë

RRITJA DHE ZHVILLIMI I FËMIJËVE TË MOSHËS PARASHKOLLORE
NË KOMUNËN E FERIZAJT

Shkalla Bachelor

Kastriot Ilazi

Prill / 2021

FERIZAJ



Kolegji UBT

Fakulteti i Infermierisë

Punim Diplome

Viti akademik 2017/2018

Kastriot Ilazi

**RRITJA DHE ZHVILLIMI I FËMIJËVE TË MOSHËS PARASHKOLLORE
NË KOMUNËN E FERIZAJT**

Mentori: Ibadete Bucaliu, Dr.Sci.MA

Prill / 2021

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Shumë studime argumentojnë vazhdimisht se fëmijëria e hershme është periudha më e rëndësishme dhe më efektive ku ndërtohet baza për jetë, punë dhe për arritshmëri më të lartë në të ardhmen, në krahasim me të gjitha periudhat tjera të jetës njerëzore.

Duke ditur rëndësinë e kësaj periudhe në vende të ndryshme të botës, i kushtojnë rëndësi shumë të madhe duke filluar nga politikëbërësit duke hartuar kurrikula, dokumente, qasje, metoda, teknika, trajnime për edukatorët, duke bërë fushata të ndryshme për vetëdijësimin e shoqërisë në përgjithësi.

Synimi kryesor i këtij hulumtimi është që të identifikohen faktorët që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve në moshën parashkollore në komunën e Ferizajit. Në këtë hulumtim morën pjesë 30 fëmijë të institucionit parashkollor në komunën e Ferizajit.

Fjalët kyçe: Rritje , Zhvillim , Perceptim

MIRËNJOHJET/FALENDERIMET

Fillimisht falënderoj Zotin që më ka dhënë mundësinë të kem shëndet të plotë mendor dhe fizik që të arrijë këtu ku jam sot.

Falënderoj familjen time për mbështetjen e vazhdueshme morale dhe financiare në çdo fazë të ngritjes sime akademike.

E falënderoj shumë mentoren time, Dr.Ibadete Bucaliu për ndihmën e pakursyer përgjatë realizimit dhe finalizimit të këtij punimi.

PËRMBAJTJA

ABSTRAKT	iii
MIRËNJOHJET/FALENDERIMET	iv
PËRMBAJTJA.....	v
LISTA E FIGURAVE.....	vi
LISTA E TABELAVE.....	vi
1.HYRJA.....	1
2.SHQYRTIMI I LITERATURËS	3
2.1Përceptimi i zhvillimit të fëmijës	4
2.2 Faktorët që ndikojnë në zhvillimin dhe rritjen e fëmijëve	5
2.2.1Roli i prindërve në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve	6
2.3. Veqorit zhvillimore te fëmijëve të moshës parashkollore.....	7
2.3.1 Rritja dhe zhvillimi fizik te fëmijëve të moshës parashkollore.....	8
2.4. Zhvillimi fizik i fëmijëve në vitet e para 1-3 të hershme të fëmijërisë	10
3.DEKLARIMI I PROBLEMIT	11
3.1Objektivat hulumtuese.....	11
3.2 Synimi kryesor	11
3.3 Hipotezat	12
4. METODOLOGJIA	13
4.1 Konceptualizimi i hulumtimit	13
4.2 Mostra.....	13
4.3.Instrumenti	14
5.PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE	15
5.1. Rritja dhe zhvillimi i fëmijëve të moshës parashkollore sipas standardeve.....	18
6.KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME	20
7.REFERENCAT	22
8.APPENDIXES	24

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 :Të dhënat për arsimimin e prindërve të fëmijëve të intervistuar	15
Figura 2: Pesha e fëmijëve të intervistuar	15
Figura 3: Gjatësia e fëmijëve të intervistuar	16
Figura 4: Të dhënat për ngrënjen e ushqimit të fëmijëve.....	16
Figura 5: Të dhënat për fëmijët se sa i shqiptojnë tingujt dhe shkronjat	17
Figura 6: Të dhënat se sa fëmija pranon veprime që i kërkohen që ti bëj gjatë aktiviteteve të ndryshme..	17
Figura 7: Të dhënat se sa janë të aftë fëmijët në kryerjen e lëvizjeve motore	18

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Moshë e fëmijëve	13
Tabela 2: Gjinia e fëmijëve	14
Tabela 3 Vendbanimi i fëmijëve	14
Tabela 4: Besueshmëria e pyetësorit sipas Cronbach's Alpha.....	14
Tabela 5: <i>Rritja e fëmijës deri në moshën 6 vjecare</i>	18

1.HYRJA

Gjatë kujdesit për fëmijët dhe punës me ta, është me rëndësi të kuptohet zhvillimi i tyre. Është e pamundur të mendohet për përmbushjen e nevojave të fëmijëve sepse nuk e dijmë çka pritet prej fëmijëve, fjala bie, në raport me të menduarit, komunikimin dhe aftësitë fizike. Rritja nënkupton zmadhimin e dimensioneve të trupit – për nga gjatësia, pesha dhe sferat e tjera që mund të maten. Zhvillimi është përvetësim i shkathtësive në të gjitha aspektet e jetës së fëmijës. Llojet e ndryshme të zhvillimit shpeshherë janë të ndarë në katër fusha: Zhvillimi fizik - kjo ka të bëjë me shkathtësitë dhe mundësitë e trupit dhe përfshin: (Bella, 2006)

- Zhvillimin e motorikës së përgjithshme (shfrytëzimi i muskujve të mëdhenj), siç janë këmbët dhe duart;
- Zhvillimin e motorikës së lehtë (përdorimi preciz i muskujve), siç janë pëllëmbët dhe gishtat
- Zhvillimi social dhe emocional – është zhvillim i identitetit dhe ndjenjave për vetveten dhe mësimi i shkathtësive për të jetuar në shoqëri me njerëz të tjerë.
- Zhvillimi intelektual – është mësim i shkathtësive të të kuptuarit, mbamendjes dhe përqendrimit
- Zhvillimi i komunikimit dhe të folurit – është mësim se si të komunikohet me miqtë, familjen dhe të gjithë të tjerët. Megjithatë është me rëndësi të kuptohet se të gjitha fushat e zhvillimit janë të lidhura mes vete.

Me lindjen e njeriut në fakt ndodhë një ndryshim i jashtëzakonshëm nga dy qeliza të vogla, siç janë qeliza vezë dhe spermatozoidi, të cilat bashkohen gjatë fekondimit të tyre, deri në një organizëm të ndërlikuar, siç është foshnja pas lindjes. (Ping,2005)

Pastaj, nga një qenie e pandihmë gjatë lindjes deri në moshën 16-vjeçare fëmija ndryshon në një personalitet të ri kompleks, i cili i ka të gjitha shkathtësitë e nevojshme themelore për jetë, duke përfshirë të folurit, vrapimin, shkrimin dhe aftësinë që të mendohet në mënyrë abstrakte.

- Pesha rritet nga 3 deri në 4 kg, që është gjatë lindjes, deri në peshën mesatare prej 65 kg të një djali të ri.

- Gjatësia, që gjatë lindjes është rreth 35 cm, ndryshon në më shumë se 155 cm. (Davis ,2005).

- Nga lëvizjet me hapje të duarve dhe kapje automatike të gjithë asaj që i jepet në dorë, fëmija mësohet se si ta kapë dhe përdorë lapsin, e pastaj zhvillohet që të mund të mbajë dhe përdorë stilolaps, kompjuterë dhe pajisje tjetër teknike. (*Karaj, 2005*).

Rritja dhe zhvillimi janë të lidhura, por dallohen shumë mes vete. Rritja është zmadhim shumë i dukshëm i madhësisë së fëmijës. Ajo mund vërehet në mënyra të ndryshme, duke përfshirë edhe rritjen e peshës, rritjen e gjatësisë dhe rritjen e vëllimit të kokës. (*Leslie , & Dean ,1990*)

Fëmijëria e hershme është një koncept shumëdimensional që përfshin periudhën prej para lindjes deri në moshën 8-9 vjeç). Gjatë kësaj periudhe kanë hov të madh të gjitha aspektet zhvillimore siç janë: zhvillimi kognitiv, social, emocional, gjuhësor, fizik etj.(*Magnuson K., 2007*).

Shumë studime argumentojnë vazhdimisht se fëmijëria e hershme është periudha më e rëndësishme dhe më efektive ku ndërtohet baza për jetë, punë dhe për arritshmëri më të lartë në të ardhmen, në krahasim me të gjitha periudhat tjera të jetës njerëzore.

Duke ditur rëndësinë e kësaj periudhe në vende të ndryshme të botës, i kushtojnë rëndësi shumë të madhe duke filluar nga politikëbërësit duke hartuar kurrikula, dokumente, qasje, metoda, teknika, trajnime për edukatorët, duke bërë fushata të ndryshme për vetëdijësimin e shoqërisë në përgjithësi. (*MooneyC, 2000*).

2.SHQYRTIMI I LITERATURËS

Teoritë e zhvillimit të fëmijëve ndryshojnë shumë nga qëllimi dhe përmbajtja që kanë. Kështu, teoria psikoanalitike fokusohet në aspektet emocionale dhe motivuese të zhvillimit, ndërsa teoritë e të nxënës fokusohen kryesisht në efektet që ka mjedisi në sjelljen e fëmijës dhe, në veçanti, në atë se si të rriturit duhet të sillen dhe të kontrollojnë veprimet e tyre. *(Bella, 2006)*.

Teoria e Piazhës fokusohet në zhvillimin e funksioneve intelektuale: në zgjidhjen e problemeve dhe formimin e koncepteve. *(Magnuson, 2007)*.

Teoria e përpunimit të informacionit fokusohet kryesisht në vëmendjen, kujtesën dhe aftësitë për të zgjidhur problemet. Edhe pse në përmbajtje teoritë nuk ndryshojnë shumë, ato dallohen ndërmjet tyre në shpjegimin e çështjeve themelore, të natyrës së zhvillimit të fëmijës *(Kamani, 2004)*.

Disa nga teoritë e paraqesin fëmijën krejt pasiv ndaj zhvillimit. Sipas tyre, fëmijët vetëm kundërveprojnë ndaj stimujve të mjedisit, por nuk inicojnë sjellje të caktuara. Shumë teoricienë e shikojnë zhvillimin si grumbull të asocimeve të mësuara, që janë rezultat i mjedisit, stimulit dhe përgjigjes. *(Karaj, 2005)*.

Asnjë njeri nuk kishte ndikim aq të madh në studimin e aftësive mendore të fëmijëve sa Zhan Piazhë (Jean Piaget) Edhe pse ka disa probleme në kuptimin e shpjegimeve dhe përshkrimeve të këtij zhvillimi, Piazhë definoi shumë çështje të rëndësishme në zhvillimin e të menduarit të fëmijëve dhe teoria e tij frymëzoi një filozofi nga e cila vazhdon të ndikohet edukimi *(Presley & Cormick, 2007)*.

Piazhë argumentoi se fëmijët nuk presin të tjerët që t'u shtrojnë probleme për zgjidhje, ata i gjejnë vetë ato. Është në natyrën e tyre të jenë kuriozë, kërkues dhe të interesuar ndaj gjërave të reja. *(Johan, 2008)*.

E thënë më thjeshtë, ata që merren me fëmijët duhet të dinë se, pavarësisht nga mosha dhe stadi i zhvillimit, të gjithë fëmijët janë të prirur të përmirësojnë dhe pasurojnë të kuptuarit e tyre për botën që i rrethon. Zhvillimi i mirë kognitiv kërkon një mjedis të pasur, mjedis që ngacmon dhe nxit kuriozitetin e fëmijëve. *(Konstantina & Sakellariou, 2010)*.

Nga kjo pikëpamje, pasiviteti dhe mungesa e kuriozitetit tek fëmijët konsiderohet si gjendje jonormale.

Duke u bazuar në këto qëndrime të Piazhës, nënkuptohet që fëmijët të cilët kanë qenë të privuar nga ambienti nxitës, me larmi të objekteve, lodrave, ngjyrave, formave etj. nuk mund të kenë zhvilluar aq sa duhet të menduarit e tyre dhe se tek ta do të shfaqen vështirësi qysh në fillim të regjistrimit në klasën e parë. (*Goodall & Montgomery, 2014*).

Përderisa mendimtarët e tjerë të kohës së tij argumentonin se të mësuarit është ose i brendshëm (vjen nga fëmija) ose i jashtëm (imponohet nga ambienti, ose mësohet nga të rriturit), Piazhë mendonte se asnjëri pozicionim si i veçantë nuk e shpjegon të nxënë, por që ndërveprimi i fëmijës me ambientin që e rrethon është ajo që mundëson të mësuarit. Ai pohonte se fëmijët ndërtojnë dijet e tyre duke i dhënë kuptim njerëzve vendeve dhe gjërave të botës së tyre. Ai ishte adhurues i thënies "ndërtimi është mbi të mësuarit" (*Hendrick, 1992*).

2.1 Përceptimi i zhvillimit të fëmijës

Zhvillimi i fëmijës i referohet sekuencës së ndryshimeve fizike, gjuhësore, mendimore dhe emocionale që ndodhin tek një fëmijë nga lindja deri në fillimin e moshës së rritur. Gjatë këtij procesi një fëmijë përparon nga varësia nga prindërit / kujdestarët e tyre në rritjen e pavarësisë. Zhvillimi i fëmijës ndikohet fuqimisht nga faktorët gjenetikë (gjenet e kaluara nga prindërit e tyre) dhe ngjarjet gjatë jetës para lindjes. Gjithashtu ndikohet nga faktet mjedisore dhe aftësia mësimore e fëmijës. (*Ping, 2005*).

Zhvillimi i fëmijës mbulon fushën e plotë të aftësive që një fëmijë zotëron gjatë gjithë jetës së tij, përfshirë zhvillimin në: Njohja - aftësia për të mësuar dhe zgjidhur problemin Ndërveprimi shoqëror dhe rregullimi emocional - bashkëveprimi me të tjerët dhe zotërimi i vetëkontrollit . Fjalimi dhe gjuha - kuptimi dhe përdorimi i gjuhës, leximi dhe komunikimi Shkathtësitë fizike - aftësitë motorike të hollë (gishtat) dhe aftësitë motorike bruto (tërë trupi) Ndërgjegjësimi ndijor - regjistrimi i informacionit ndijor për përdorim.

Në vitet e fëmijërisë së hershme, fëmijët nuk rriten vetëm në peshë dhe gjatësi. Zhvillimi i tyre përfshin disa fusha si: (*Davis, 2005*).

- **Zhvillimi fizik** përfshin zhvillimin e lëvizjeve, ekuilibrin, zhvillimin e aftësive për të përdorur muskujt e mëdhej të trupit (p.sh. muskujt e shpinës, të këmbëve, që janë të nevojshëm për të ecur, për të vrapuar, për t'u hedhur, për të ngjitur shkallët) dhe muskujt e vegjël (p.sh. muskujt e duarve që janë të nevojshëm për të kapur objekte të vogla), ose që ndryshe quhet zhvillim i madh motor dhe zhvillim i motorikës fine.

- **Zhvillimi social dhe emocional** është aftësia e fëmijës për të krijuar dhe për të mbajtur marrëdhëniet e krijuara me të tjerët. Fëmijët e vegjël mësojnë të bëjnë miq, marrin pjesë në grupet e lojës, tregojnë empati për të tjerët, bashkëpunojnë dhe krijojnë konceptet e dhënies dhe marrjes, zhvillojnë besim, vetëvlerësim dhe kontroll të emocioneve. (*Goodall, & Montgomery, 2014*).
- **Zhvillimi njohës** (konjitiv) i referohet aftësisë për të mësuar dhe menduar në shumë mënyra, gjithnjë e më të ndërlikuara. Në vitet e para fëmijët zhvillojnë kuriozitetin dhe mësojnë të bëjnë pyetjet “pse”, “kur”, dhe “ku”. Ata mësojnë të njohin ngjyrat, gërmat dhe numrat, fokusohen në bërjen e detyrave dhe “zgjidhjen e problemeve”.
- **Zhvillimi i komunikimit** përfshin aftësinë për të kuptuar gjuhën dhe për të shprehur nevojat, mendimet dhe emocionet nëpërmjet fjalëve. Përgjatë viteve të para të fëmijërisë, fëmijët kalojnë nga gugatja në të folurën e një apo dy fjalëve, derisa thonë një fjali të plotë. Ata kanë interes të dëgjojnë histori, dhe fillojnë të lexojnë nëpërmjet librave me përralla. (*Magnuson, 2007*).

Aftësia përshtatëse i referohet aftësive zhvilluese të fëmijës për t’u përshtatur me ambientin rrethues dhe për të rregulluar rutinën e përditshme. Në fund të viteve të para, shumica e fëmijëve janë në gjendje të vishen vetë, të hanë, të lajnë dhëmbët dhe të shkojnë në tualet pa ndihmën e të rriturve.

2.2 Faktorët që ndikojnë në zhvillimin dhe rritjen e fëmijëve

Egzistojnë disa faktorë që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës që janë:

- Faktorët mjedisorë.: Shkolla dhe familja luajnë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e tij. Për ta thënë më thjesht, një fëmijë i ushqyer mirë dhe rritur në një mjedis të mirë do të ketë zhvillimin e duhur.
- Ndikimi familjar.: Familja është faktori më i rëndësishëm kur vjen puna tek zhvillimi i fëmijës. Janë pikërisht familjarët që vendosin lidhjet e para të fëmijës. Familja e ushqen fëmijën me dashuri dhe gjëra pozitive duke e lënë nga ana tjetër të lirë edhe të mësojë nëpërmjet eksperiencave negative. Nëse investoni kohë dhe dashuri tek fëmija juaj me siguri do të shihni frytet pozitive. Nëse e neglizhoni dhe abuzoni me fëmijën tuaj sigurisht do të vëreni anët negative.

- Faktori gjeografik: Vendi ku jeton fëmija ka ndikimin e tij të rëndësishëm. Si janë shkollat, si janë shërbimet që ai merr në komunitet, a merr një kujdes të mirë shëndetësor etj. (*Ping,2005*).
- Faktorët socio-ekonomik: Ky faktor do të ndikojë që fëmija të ketë një ushqyerje jo të mirë, të shkojë në një shkollë të mirë ose jo, dhe shpesh mundësitë e dobëta ekonomike do të ndikojnë negativisht që fëmija të arrijë të zhvillojë të gjithë potencialin. (*Greenspan & Shanker, 2004*).

2.2.1 Roli i prindërve në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve

Me zhvillim kuptojmë ndryshimet në karakteristikat fizike, kognitive, sociale, emocionale. Në këto sfera të zhvillimeve rolë të rëndësishëm luajnë prindërit në raport me fëmijën, në qasjen me fëmijët, bashkëpunimin, kujdesin, interesimin, nxitjen e fëmijës për të qenë aktiv, kreativ, komunikues, tolerant, bashkëbisedues etj. Sjellja dhe reagimi i prindërve ndikon në pjesën e zhvillimit emocional, social, moral, kognitiv të fëmijët, duke e kuptuar këtë si shembull dashuria, toleranca, bashkpunimi, mirkuptim, komunikimi me fëmijët kanë një efekt shumë të mirë për sjelljen e fëmijëve si dhe kritika, agresiviteti, reagimi emocional, komunikimi jo i përshtatshëm kanë efekte negative në sjelljet e fëmijës. Si mjedis i parë social dhe edukativ është familje e cila paraqet segmentin e rëndësishëm në procesin e njohjes dhe zbulimit të botës së jashtme. (*Magnuson , 2007*).

Në një kulturë ku jeta shoqërore po bëhet gjithnjë e më komplekse, personaliteti është i rëndësishëm. Është e rëndësishme sepse kjo varet shumë më tepër nga ajo që fëmijët mësojnë prej tyre. Si karakteristika pozitive që mund të ndikojnë në të ardhmen e fëmijës janë: aftësia për të krijuar marrëdhënie me njerëzit, aftësia për të mësuar, për t'u përshtatur, aftësia për t'u përqendruar, aftësia për të qenë krijues, i vendosur, tolerant, ambicioz, të gjitha këto do ta ndihmojnë fëmijën për një të ardhme me vlera. Lidhur me zhvillimin e fëmijës, sjelljet e tyre, edukimin rol të rëndësishëm kanë llojet e prindërimit. Mund të themi shembull tek prindi agresiv mundësia për bashkpunim me fëmijët është i vështir, niveli i socializimit tek fëmijët është i ulët, pjesa emocionale fëmija është i ndejshëm, reagues, i mbyllur në vetvete. Prindërit agresiv siç thuhet nga (*Biddulph, 2006*) nxjerrin ose fëmijë të trembur e frikacakë, ose fëmijë rebel e të pa shtruar ose të dyja bashkë. Prindërit pasiv për të cilën mungon bashkpunimi me

fëmijët, kreativiteti, angazhimi, komunikimi, duke u dorëzuar pranë fëmijës së tij, fëmija nuk sillet konform rregullave, kur fëmija bashkëpunon me prindin dihet se kjo ndikon pozitivisht tek fëmija në sferën e tij emocionale, sociale si dhe duke ndikuar pozitivisht në performancën mësimore. (Davis, 2005).

- Prindi kërkues është lloji i prindit që sipas psikologut Biddulph janë të qartë, të vendosur të sigurt të qetë dhe kjo qasje, sjellje reflekton pozitivisht në personalitetin e fëmijës. Dihet se fëmija përjeton emocione të ndryshme gëzim, pikëllim, i disponuar, i shqetësuar të gjitha këto janë normale. Por nëse fëmija jeton në një mjedis të qetë, të rregulluar, të cilat përveç nevojave fiziologjike do të jenë të kënaqura edhe nevojat e saj emocionale për simpati, ngrohtësi, dashuri prindërore.

2.3. Veqorit zhvillimore te fëmijëve të moshës parashkollore

Nëse dëshirohet te punohet drejt me fëmijët e moshës parashkollore, njëri ndër kushtet kryesore është që te punohet në përputhshmëri të plote me karakteristikat e zhvillimit dhe rritjes së tyre. Fëmijët nga të rriturit kërkojnë vetëm një gjë dhe kjo është ti kuptojmë ata dhe ti pranojnë ashtu si janë me të gjitha karakteristikat e tyre. (Grup autoresh, 1999).

Përkundrazi asaj që parimisht karakteristikat anatomiko fiziologjike janë të njëjta për të gjithë njerëzit, megjithatë në mes të njerëzve ekzistojnë edhe ndryshime për të cilat duhet të kujdesemi në punën me fëmijët e moshës parashkollore. (Bella, 2006).

Njohja e fëmijëve nënkupton:

- zhvillimit fizik dhe motorik të fëmijëve (cilat janë karakteristikat themelore të aftësive të tyre motorike)
- aftësitë e tyre njohëse dhe emocionale (ndjenja, vëmendja, kujtesa, të menduarit).
- zhvillimin psikologjik (të folurit dhe imagjinata),
- mënyra se si ata ndërtojnë marrëdhëniet e tyre sociale dhe emocionale me të tjerët,
- cilat janë interesat e tyre,
- Nëse njohim këto karakteristika atëherë zhvillimi i programeve të edukimit fizik dhe shumë aktivitete të tjera janë shumë më të lehta që të realizohen me fëmijët e moshës parashkollore. (Konstantina, 2010).

Periudhat e zhvillimit të fëmijëve përfshin:

Fëmijërinë e hershme- nga lindja deri 3 vjet.

- Nga 1-4 javë – moshë e te porsalindurit
- Nga 5 javë- 10 muaj- faza e ushqimit me gji,
- Nga 10-15 muaj- faza e zhagjitjes dhe e fillimit të ecjes
- Nga 15-24 muaj- moshë e mesëm e fëmijërisë së hershme
- Nga 2-3 vjeç- moshë e vjetër e fëmijërisë së hershme (Ping, 2005).

Moshë parashkollore- nga 3-6 apo 7 vjeç.

- Nga 3-4 vjeç- moshë e re parashkollore
- Nga 4-5 vjeç moshë e mesme parashkollore
- Nga 5-6 apo 7 moshë e vjetër parashkollore (Mooney,2000).

2.3.1 Rritja dhe zhvillimi fizik të fëmijëve të moshës parashkollore

Rritja e trupit : është, nga pikëpamja biologjike, riprodhimi i qelizave që përbëjnë trupin tonë, ndryshimet natyrore, madhësia e trupit (lartësia, pesha), që shkaktohen nga shumimi i qelizave dhe rritjen e substancave ndërqelizor.

Zhvillimi fizik: paraqet ndryshim cilësor në strukturën e organeve të caktuara dhe indeve, ndryshimet në nivelin e performancës individuale (ndryshim cilësor). Pjekuria histologjike dhe funksionale të organeve (trurit, mëlçisë, veshkave etj). (Karaj, 2005).

Rritja dhe zhvillimi fizik i fëmijëve të moshës parashkollore është i vrullshëm e posaçërisht menjëherë pas lindjes, kur rritja mesatare në gjatësi trupore është 23-24 cm, dhe me një shtim në peshë rreth 7 kg. (Magnuson ,2007).

Në moshën parashkollore fëmija rritet përafërsisht 5-6 cm në vit, dhe kjo është një kohë e rritjes së shpejtë, dhe një shtim në peshë rreth 2kg në vitë.

Proporcionet trupore të fëmijët

Te i porsalinduri koka përbën $\frac{1}{4}$ e trupit, këmbët $\frac{1}{3}$ ndërsa tek i rrituri koka ka $\frac{1}{8}$ ndërsa këmbët dikë mbi $\frac{1}{2}$:

- Koka rritet 75%
- Trungu 188 %
- Krahët 240 %

- Këmbët 400%
- Trupi 240%

Veçoritë e organizmit të fëmijëve

Një ndër karakteristikat kryesore të organizmit të fëmijëve është elasticiteti i trupit, të cilën mund ta definojmë si aftësi e ndryshimit të lehtë nën ndikimin e kushteve të favorshme apo të pafavorshme. Ky është një detaj për të cilin duhet të kemi kujdes gjatë punës me fëmijët e moshës parashkollore, e për ta bërë këtë duhet ti njohim mirë veçoritë e organizmit të fëmijëve. Rritja dhe zhvillimi janë procese dinamike të cilat zhvillohen nga baza d.m.th në trupin e nënës në 9 muaj, pas lindje e deri përafërsisht në moshën 20 vjeçare. Rritja dhe zhvillimi varen nga faktoret endogjen dhe egzogjen. Gjatë rritjes në barkun e nënës 9 mujore fryti arrin gjatësinë përafërsisht 50cm. Gjatë zhvillimit në barkun e nënës më së shumti rritet në muajt e 6 dhe 7. (*Magnuson, 2007*).

Pas lindjes rritja më e hovshme bëhet në vitin e parë të jetës. Ngjarja më e rëndësishme është HAPI I PARË apo ndryshe „Faza e jetës së re” Me fillimin e ecjes fëmija jo vetëm ngritet nga toka por e ngrit edhe nivelin e të jetuarit në nivel më të lartë duke pasqyruar pavarësinë të cilën e siguron përmes ecjes. Eshtrat e fëmijëve janë të butë dhe kanë shumë më shumë ujë se material të fortë ashtrore (kërcore). Rritja dhe pjekuria ndodhin nga poshtë- lartë. (Nga eshtrat e shpëtës deri te eshtrat e kokës). (*Mooney., 2000*).

Shtylla kurrizore deri në 4 muajt e parë është e drejtë, lakimi i parë paraqitet kur fëmija fillon ta ngrit kokën lartë. Lakimi në pjesë llumbale paraqitet në fazën kur fëmija fillon të ulet dhe ecë (këto lakime janë të paqëndrueshme andaj duhet pas kujdes me ngarkesat).

Muskujt: Përqindja e peshës në raport me peshën trupore

- Te i porsalinduri 23%
- Deri në moshën 3 vjeçare 27%
- Në fillim të pubertetit 33%
- Te i rrituri 43%

Me shumë janë të zhvillur muskujt fleksor të përparëm se estenzor dhe muskujt e mëdhenje.

Duhet aplikuar ushtrime dinamike e jo statike. (*Ping.,2005*).

2.4. Zhvillimi fizik i fëmijëve në vitet e para 1-3 të hershme të fëmijërisë

Për zhvillimin anatomik-fiziologjike një rol të rëndësishëm luan trashëgimia, në të cilën ndikojnë mjedisi dhe aktivitetet fizike. Për zhvillimin fizik është i rëndësishëm shëndeti, sepse të gjitha sëmundjet mund të pengojnë apo edhe të parandalojnë zhvillimin e mëtejshëm të fëmijës. Ka dy periudha të rritjes së shpejtë të fëmijës; periudha nga lindja deri në gjashtë vjet dhe periudha e pubertetit. Eshtrat e fëmijëve janë të bute dhe me kalimin e kohës forcohen dhe indet bëhen me te dendura. Muskujt e fëmijës gjatë kësaj periudhe bëhen më të gjatë dhe më të rënda, dhe të fortë. Dhe pesha e trupit rritet me zhvillimin e muskujeve. (Mooney, 2000).

Trupi, këmbët dhe duart rriten shpejt në këtë periudhë, kështu që fëmija behet me i shkathet ne lëvizje dhe ne kapje. Fëmija ne vitin e dytë rritet me një tempo te stabilizuar dhe shumë më të ngadalshëm se ne vitin e parë të jetës. Në vitin e tretë te jetës, fëmija zgjatet. (Polloshka, 1984).

Zhvillimi fizik i fëmijëve në vitet e para 3-6 të hershme të fëmijërisë

Fëmijë në këtë fazë ende zhvillohet fizikisht dhe gjithnjë bëhet më i gjatë dhe më i rëndë. Fëmija tani më është shumë i kujdesshëm me rastin e përdorimit te pasjeve për ngrenje dhe mundet ne mënyr të pavarur të ushqehet. Kontrolli i urinimit është mjaft i mire dhe 6 vjeçare vet e kontrollojn për dallim nga 3 vjetarët.

- Fëmijët në këtë moshë gradualisht flejë më pak dhe ne fund të kësaj periudhe ata flejë 10-11 ore, por këtu ekzistojnë dallime të mëdha individuale.
- Fëmijët e moshës 6-7 vjeç bëjnë më pak për gjumë sesa fëmijët nga 4 dhe 5 vjet.
- Fëmijët parashkollor endërrojn shumë, dhe zakonisht ëndrrat janë të këndshme dhe paraqesin përditshmërinë, nganjëherë janë edhe te trishtuara.
- Te fëmijët më së shpeshti sëmuren organet e frymëmarrjes fyti dhe mushkрит.

Aksidentet janë të zakonshme te fëmijë dhe ato janë ramjet e ndryshme dhe aksidentet e trafikut, dhe më shpesh ndodhin te djemtë sesa tek vajzat. (Karaj, 2005).

3.DEKLARIMI I PROBLEMIT

Rritja dhe zhvillimi i fëmijëve në moshë të hershme është një problematik që është shqyrtuar nga shumë ekspert të fushave të ndryshme, të cilët kanë treguar pikpamjet e tyre lidhur me këtë qështje shumë të rëndësishme.

3.1Objektivat hulumtuese

Ky studim është realizuar me anë të metodës kuantitative dhe ka një rëndësi shumë të madhe sidomos për prindërit që mund të shohin faktorët që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve. Për realizimin e këtij studimi të llojit kuantitativ, fillimisht i kemi zhvilluar tri objektiva hulumtuese. Nëpërmjet këtyre objektivave hulumtuese ne do të mundohemi të identifikojmë rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve në moshën parashkollore në komunën e Ferizajit.

1. Të vlerësojmë faktorët që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve në moshën parashkollore
2. Të vlerësojmë rolin dhe rëndësia e prindërve në zhvillimin e fëmijëve në moshën parashkollore në komunën e Ferizajit
3. Të vlerësojmë veçoritë e zhvillimit të fëmijëve

3.2 Synimi kryesor

Synimi kryesor i këtij hulumtimi është që të paraqesim zhvillimin e fëmijëve në moshën parashkollore , faktorët që ndikojnë në zhvillimin e këtyre fëmijëve .Më saktësisht me anë të këtij hulumtimi do të përshkruhet më mirë veçoritë që e karakterizojnë këtë moshë , zhvillimin fizik në këtë moshë si dhe aftësitë krijuese që posedojnë këta fëmijë .

3.3 Hipotezat

Gjatë procesit të përpilimit të projektit hulumtues dhe gjatë analizimit dhe shqyrtimit të literaturës janë zhvilluar tri hipoteza, të cilat janë:

- I. Fëmijët në moshën parashkollore kanë zhvillim fizik në bazë të moshës së tyre
- II. Prindërit kanë ndikim në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve në moshën parashkollore
- III. Faktorët mjedisor , ndikimi familjarë , faktori gjeografik dhe faktori ekonomik ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve në moshën parashkollore.

4. METODOLOGJIA

4.1 Konceptualizimi i hulumtimit

Në këtë hulumtim është përdorur si metodë anketimi pytësori ku me anë të tij kemi nxjerr të dhëna e fëmijëve si dhe faktorët që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve parashkollor në komunën e Ferizajit.

4.2 Mostra

Mostrën e përgjithshme të këtij studimi e përbëjnë 30 fëmijë që i kemi intervistuar në instucionin parashkollorë në komunën e Ferizajit të dhënat për fëmijët i kemi marr nga edukatorja që ajo çdo ditë është me ta dhe na jepte informacione për plotësimin e pytësorit.

Tabela 1: Mosha e fëmijëve

		Frekuenca	Perqindja	Perqindja Valide	Perqindja komulative
Valid	a) 4 vjeq	10	4.9	33.3	33.3
	b) 5 vjeq	10	4.9	33.3	66.7
	c) 6 vjeq	10	4.9	33.3	100.0
	Total	30	14.7	100.0	
Total		30	100.0		

Pjesëmarrësit në këtë hulumtim ishin fëmijët me grup mosha të ndryshme siç po shihet edhe në tabelë , 10 fëmijë ishin 4 vjeç, 10 fëmijë tjerë 5 vjeç dhe 10 të tjerë 6 vjeç.

Në tabelë janë paraqitur të dhënat e fëmijëve për gjininë, 14 prej tyre janë të gjinisë femërore dhe 16 të tjerë janë të gjinisë mashkullore.

Tabela 2: Gjinia e fëmijëve

		Frekuenca	Perqindja	Perqindja Valide	Perqindja Komulative
Valid	a) Femer	14	6.9	46.7	46.7
	b) Mashkull	16	7.8	53.3	100.0
	Total	30	14.7	100.0	
Total		30	100.0		

Nga kjo tabelë e paraqitur kuptojmë se 14 fëmijë ishin me vendbanim në Ferizaj, 10 të tjerë në Varosh dhe 10 fëmijë të tjerë në Bibaj.

4.3.Instrumenti

Tabela 3: Vendbanimi i fëmijëve

		Frekuenca	Perqindja	Perqindja Valide	Perqindja Komulative
Valid	a) Ferizaj	14	6.9	46.7	46.7
	b) Varosh	10	4.9	33.3	80.0
	c) Bibaj	6	2.9	20.0	100.0
	Total	30	14.7	100.0	
Total		30	100.0		

Instrument themelor për përpunimin e të dhënave kemi përdorur pyetësin ku i kemi paraqit rezultatet me grafika pyetjet i kemi realizu në bazë të moshës së fëmijëve dhe karakteristikat themelore që e veçojnë këtë moshë.

Për të parë qëndrueshmërinë e këtij pyetësi, është bërë Analiza e Cronbach's Alfa, e cila ka treguar një konsistencë të shkëlqyeshme me vlerë prej .829.

Tabela 4: Besueshmëria e pyetësit sipas Cronbach's Alpha

Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha Based on Standardized Items	N of Items
.829	.829	8

5.PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE




Figura 1 :Të dhënat për arsimimin e prindërve të fëmijëve të intervistuar

Arsimim i prindërve të fëmijëve të intervistuar 10 prej tyre kanë pasur arsimim fillor 8 prej tyre arsimim të mesëm dhe 12 arsimim të lartë




Figura 2: Pesha e fëmijëve të intervistuar

Nga kjo figurë kuptojmë se 18 fëmijë kishin peshë 15-20 Kg dhe 12 fëmijë kishin peshë 20-30 Kg.




Figura 3: Gjatësia e fëmijëve të intervistuar

Nga kjo figurë e paraqitur kuptojmë se 15 fëmijë kishin gjatësinë 103m, 11 fëmijë kishin gjatësinë 110m dhe 4 fëmijë kishin gjatësinë 120m.




Figura 4: Të dhënat për ngrënjen e ushqimit të fëmijëve

Nga kjo figurë kuptojmë se prej 30 fëmijëve që janë intervistuar, 17 prej tyre kanë ngrënë ushqim tre herë në ditë, 8 prej tyre dy herë në ditë kanë ngrënë ushqim dhe 5 prej tyre më

shumë se tre herë në ditë. Nga kjo grafikë kuptojmë 5 prej tyre kanë qene me obezitet gjë që ndikon shumë në zhvillimin fizik të fëmijës.




Figura 5: Të dhënat për fëmijët se sa i shqiptojnë tingujt dhe shkronjat




Figura 6: Të dhënat se sa fëmija pranon veprime që i kërkohen që ti bëj gjatë aktiviteteve të ndryshme

Nga kjo figurë kuptojmë se 19 fëmijë pranojnë të bëjnë veprime që i'u kërkohet gjatë aktiviteteve të ndryshme ndërsa 11 fëmijë nuk pranojnë .




Figura 7: Të dhënat se sa janë të aftë fëmijët në kryerjen e lëvizjeve motore

Nga kjo figurë kuptojmë se fëmijët që janë intervistuar, 18 prej tyre kryejnë lëvizje motore që u kërkohet shumë mirë, 10 prej tyre mirë dhe vetëm 2 prej tyre kryejnë lëvizje motore që u kërkohet gjatë një aktiviteti deri diku mirë.

5.1. Rritja dhe zhvillimi i fëmijëve të moshës parashkollore sipas standardeve të rritjes

Për të krijuar një pasqyrë krahasuese të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve të moshës parashkollore me rezultatet e punimit iu referuam të dhënave standarde në tabelën e rritjes së fëmijëve të publikuara (pernenat,2021).

Tabela 5: Rritja e fëmijës deri në moshën 6 vjecare

<i>Mosha e fëmijës</i>	<i>Pesha e fëmijës</i>	<i>Gjatesia e fëmijës</i>
Viti 4	13-20 kg	92-109 cm
Viti 5	14-24 kg	99-116 cm
Viti 6	16-29 kg	105-124 cm

Referuar parametrave të rritjes, fëmijët e vlerësuar në punimin e kësaj teme, 25 prej tyre treguan rritje normale në raport me standardet e rritjes për moshën e tyre kurse 5 nga ta ishin mbipeshë në raport me këto standarde.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Zhvillimi i individit është një proces kompleks që nis në periudhën prenatale dhe vazhdon përgjatë gjithë hapësirës jetësore të tij. Zhvillimi ndodh në disa dimensione siç janë: zhvillimi fizik, zhvillimi motorik, zhvillimi konjitiv, zhvillimi perceptiv, zhvillimi social, zhvillimi emocional, zhvillimi moral, zhvillimi gjuhësor, etj. Të gjitha këto dimensione janë të ndërthurura dhe ndihmojnë zhvillimin e njëri-tjetrit. Zhvillimi mund të ndodhë vetëvetiu, si pasojë e maturimit, që është procesi i rritjes i kontrolluar gjenetiksht. Në anën tjetër, gjithashtu, ai ndikohet nga praktikatat e përshtatshme të mirërritjes dhe stilit të jetesës, të cilat mund ta nxisin dhe përshpejtojnë, ashtu sikurse praktikatat dhe stilet e jetesës të papërshtatshme mund ta pengojnë apo ngadalësojnë atë.

Në këtë hulumtim është përdorur si metodë anketimi pyetësori ku me anë të tij kemi nxjerr të dhëna e fëmijëve si dhe faktorët që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve parashkollorë. Mostrën e përgjithshme të këtij studimi e përbëjnë 30 fëmijë që i kemi intervistuar në instucionin parashkollorë në komunën e Ferizajit të dhënat për fëmijët i kemi marr nga edukatorja që ajo çdo ditë është me ta dhe na jepte informacione për plotësimin e pyetësorit. Pjesëmarrësit në këtë hulumtim ishin fëmijët me grup moshë të ndryshme siç po shihet edhe në tabelë, 10 fëmijë ishin 4 vjeç, 10 të tjerë 5 vjeç dhe 10 të tjerë 6 vjeç. Për të parë qëndrueshmërinë e këtij pyetësori, është bërë Analiza e Cronbach's Alfa, e cila ka treguar një konsistencë të shkëlqyeshme me vlerë prej .829. Nga 18 fëmijë të intervistuar kishin peshë 15-20 Kg dhe 12 fëmijë kishin peshë 20-30 Kg. 15 fëmijë kishin gjatësinë 103m, 11 fëmijë kishin gjatësinë 110 m dhe 4 fëmijë kishin gjatësinë 120m. Nga hulumtimi i realizuar është vërtetuar se 19 fëmijë pranojnë të bëjnë veprime që i'u kërkohet gjatë aktiviteteve të ndryshme ndërsa 11 fëmijë nuk pranojnë. Nga fëmijët që janë intervistuar, 18 prej tyre kryejnë lëvizje motore që u kërkohet shumë mirë, 10 prej tyre mirë dhe vetëm 2 prej tyre kryejnë lëvizje motore që u kërkohet gjatë një aktiviteti deri diku mirë. Nga një vështrim mbi fushat e standardeve në Kosovë ku që kanë lidhje me treguesit e zhvillimit fizik të fëmijëve 3-6 vjeç. Vetë këta tregues kanë lidhje me aftësitë e fëmijëve për të përdorur muskujt e duarve, koordinimin sy-dorë, muskujt e mëdhenj, nëpërmjet të cilës fëmijët realizojnë prekjen dhe manipulimet me objekte të ndryshme, kryejnë ecje, lëvizje dhe veprimtari të tjera fizike.

Zhvillimi fizik dhe lëvizor është mjaft i vrullshëm në tre vjetët e parë të jetës së fëmijës, gjatë të cilave kockat dhe muskujt e fëmijës zhvillohen shumë. Sipas këtij standardi aftësitë e tyre koordinuese, të forcës apo ekuilibrit zhvillohen po kaq vrullshëm, duke bërë që ata të zhvillojnë me energji aktivitetet e tyre ditore. Ndërkohë në moshën 3-6 vjeç, për shkak të forcimit dhe maturimit të sistemit skeletor, trupi i fëmijëve parashkollorë merr një formë më të rregullt, me një pamje atletike, karakteristike për këta fëmijë.

Rekomandohet që :

1. Të rritet komunikimi mes edukatorëve dhe prindërve
2. Instucionet parashkollore të identifikojnë fëmijët që kanë problem ekonomike në mënyrë që të evitohet ndikimi në rritjen dhe zhvillimin e tyre
3. Të mbahen trajnime vetëdijuse për edukatorët në lidhje me faktorët kryesor që ndikojnë në rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve

Rekomandimet për prindërit

1. Prindërit të jenë më vigjilentë ndaj fëmijëve të tyre të mos anashkalojnë kujdesin sidomos në periudhën e hershme të fëmijërisë
2. Të rritet bashkpunimi në mes prindërve dhe edukatorëve që të jenë më të informuar sa i përket zhvillimit social të fëmijëve
3. Rekomandohet që prindërit të përcjellin ecurinë e përgjithshme të rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve të tyre në bazë të moshës që posedojnë

7.REFERENCAT

- Bella, N. e të tjerë (2006). *Strong foundations Early childhood care and education*. Retrieved from Strong foundations Early childhood care and education: http://www.unesco.org/education/GMR/2007/Full_report.pdf
- Brebner, Ch., Jovanovic, J., Laëless, A. & Young, J. (2016). Early childhood educators' understanding of early communication: Application to their work with young children. *SAGE*. 277–292.
- Konstantina, R., Sakellariou, M. (2010). The Quality of Early Childhood Educators: Children's Interaction in Greek Child Care Centers. *The Quality of Early Childhood Educators: Children's Interaction in Greek Child Care Centers*, 367–376.
- Lillard S. A. (2012). Preschool children's development in classic Montessori, supplemented Montessori, and conventional programs., *Journal of School Psychology*, 379–401.
- McMullena, M., Elicker, J., Äang, J., Erdiller, Z., Lee, S.Mi, Lin. Chia-Hui, Yun Sunf.
- Mendelson, M. J., (1990). Auditory-visual transfer for old child development, 1022-1027.
- Ping.(2005). Comparing beliefs about appropriate practice among early childhood education and care professionals from the U.S., China, Taiëan, Korea and Turkey. *Earyl Childhood Resarch Quarterly*.451–464.
- Davis-Kean P.E., (2005). The influence of parent education and family income on child achievement: The indirect role of parental expectations and the home environment. *J Fam Psychol* 19: 294–304. doi: 10.1037/0893- 3200.19.2.294.
- Fisher Y., & Kostelitz Y., (2015). Teachers' self-efficacy vs. parental involvement: Prediction and implementation. *Leadership and Policy in Schools*, 14,279–3007.
- Goodall, J. & Montgomery C., (2014). Parental involvement to parental engagement: a continuum. *Educational Revieë*, 66(4), 399-410.
- Grantham-McGregor S., Cheung Y.B., Cueto S., Gleë ë e P. & Richter L, et al. (2007). Developmental potential in the first 5 years for children in developing countries. *Lancet* 369: 60-70.
- Leslie J., & Dean T. J., (1990). "Health and Nutrition Considerations in Education Planning. 1. Educational Consequences of Health Problems among SchoolAge Children." *Food and Nutrition Bulletin* 12(3):191-203.
- Magnuson K., (2007). Maternal education and children's academic achievement during middle childhood. *Dev Psychol* 43: 1497–1512. doi: 10.1037/0012- 1649.43.6.1497
- MooneyC., (2000). *Theories of Childhood. An introduction to Deëey, Montessori, Ericson, Piaget and Vygotsky*. USA. Musai B., (1999). *Psikologji e edukimit*. Tiranë Myers D. G., (1996). *Exploring Psychology*. Neë York: Freeman & Co.
- Karaj.Th (2005): *Psikologjia e zhvillimit të fëmijës*, Tiranë

[https://outlook.live.com/mail/0/inbox/id/AQQkADAw
ATM0MDAAMS1jYTQ2LTQ1OTItMDACLTAë CgAQAGsHoSË
Py4pOsDLYK1IP8PU%3D](https://outlook.live.com/mail/0/inbox/id/AQQkADAwATM0MDAAMS1jYTQ2LTQ1OTItMDACLTAëCgAQAGsHoSËPy4pOsDLYK1IP8PU%3D)

[https://www.pernenat.al \(2021 \)/tabela-e-rritjes-se-femijes-deri-ne-moshen-6-vjecare/](https://www.pernenat.al (2021)/tabela-e-rritjes-se-femijes-deri-ne-moshen-6-vjecare/)

8.APPENDIXES

Pytësori

.Moshë e fëmijëve të intervistuar
➤ 4
➤ 5
➤ 6
2.Gjinia e fëmijëve të intervistuar Femër
➤ Mashkull
➤ Femër
3.Vendbanimi i fëmijëve të intervistuar
➤ Ferizaj
➤ Varosh
➤ Bibaj
4.Arsimimi i fëmijëve të intervistuar
➤ Arsimim fillor
➤ Arsimim i mesëm
➤ Arsimim i lartë
5.Pesha e fëmijëve të intervistuar
➤ 20
➤ 26
6.Gjatësia e fëmijëve të intervistuar
➤ 103
➤ 110
➤ 120

7. A ndikojnë faktorët socio ekonomik në rritjen dhe zhvillimin e fëmijës në moshën parashkollore
➤ Po
➤ Jo
8. Fëmija shqipton , tingujt dhe shkronjat më të përdorura
➤ Po
➤ Jo
9. Fëmija pranon veprime që kërkohen që ti bëj gjatë aktiviteteve të ndryshme
➤ Po
➤ Jo